



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1670/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit Delta Group shpk me seli në fshatin Llapnasellë Komuna Graçanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e avokatëve Hodaj&Partners në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, rivlersim doganor, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.393/22 të datës 09.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 18.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.393/22 të datës 09.11.2023, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar është vendosur si në vijim: I Aprovohet në tërsi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Delta Group shpk me seli në fshatin Llapnasellë Komuna Graçanicë, II Anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/8823 datës 15.06.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, III Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit t,ia kthej shumën prej 2,452.51€ të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore R-18761/18.05.2021, R-19295/21.05.2021, R-17251/07.05.2021, R-17753/10.05.2021, R-17540/10.05.2021, R-17817/11.05.2021, R-17779/11.05.2021, R-

19058/20.05.2021, R-18268/14.05.2021 dhe R-17989/12.05.2021 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren, me kamatë ligjore në shkallë prej 8% nga data e ushtrimit të padisë 16.07.2021 e deri në kthimin e plotë, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit ligjor, V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ushtron e paditura, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e bazuar në ligj, të prishet aktgjykimi KF.nr.393/22 i datës 09.11.2021, si i pabazuar në ligj, të Refuzohet padia dhe kërkespadia e paditësit si e pabazuar në ligj dhe ta lë në fuqi vendimin e kontestuar ose t,ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Në përgjigjen në ankes i autorizuari i paditësit kundërshton pretendimet ankimore si të pabazuara dhe abstrakte sepse gjykata ka konstatuar saktë dhe drejt të gjitha faktet vendimtare, i propozon gjykatës që ta refuzoi në tërsi si të pabazuar ankesën e pditurit kundër aktgjykimit KF.nr.393/22 dt.09.11.2023 i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, dhe të vërtetohet ky aktgjykim

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, në drejtim të theksimeve në ankesë, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë, nr.01.3.2.2/8823 i datës 15.06.2021, është Refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë Delta Group shpk me seli në fshatin Llapnasellë Komuna Graçanicë, për rishqyrtimin e vendimeve – Deklaratave Unike Doganore, si në dispozitiv të aktvendimit. Në arsyetim të vendimit administrativ theksohet se Sektori i pranimit qëndror, ka vepruar drejt kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor kontestues, dhe kur ka vlerësuar mallin bazuar në metodën e dytë, tretë dhe të gjashtë të vlersimit neni 34.2 pika a) dhe b) dhe

nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, respektivisht në bazë të mallrave identike, atyre të ngjashme dhe të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, andaj këto të dhëna të disponueshme janë përdorur në rastin konkret në bazë të cilave edhe është përcaktuar çmimi i mallit.

Paditësi Delta Group shpk me seli në fshatin Llapnasellë Komuna Graçanicë, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatë të shkallës së parë, e cila në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor me datë 09.11.2023 në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e Aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Dhoma e shkallës së parë ka arsyetuar aktgjykimin se e paditura nuk ka provuar konstatimin se vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga zhdoganimet e mëhershme dhe nga dosja e vlerës me dispozitën e nenit 31.par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nuk thuhet që vlera doganore e mallrave duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga zhdoganimet e mëhershme dhe dosja e vlerës. Gjykata aktgjykimin e referon në dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, ku nuk parashihet që kontrata është dokument i cili duhet bashkangjitur deklaratës doganore. Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore, si pasojë e vlerësimit të mallit nga e paditura, u konstatua nga ekspertiza financiare e datës 16.10.2023 e cila shumë nuk u kontestua nga e paditura.

Dhomat e Shkallës së Dytë, e pranon si të rregullt dhe të bazuar në ligj, aktgjykimin e atakuar të dhomës së shkallës së parë, për arsye se Aktgjykimi nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, apo LPK-së, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nga shkresat e lëndës nuk ka gjetur prova të argumentuara se paditësi ka deklaruar vlerë më të ulët se sa vlera e deklaruar me Deklaratat Unike Doganore kontestuese R-18761/18.05.2021, R-19295/21.05.2021, R-17251/07.05.2021, R-17753/10.05.2021, R-17540/10.05.2021, R-17817/11.05.2021, R-17779/11.05.2021, R-19058/20.05.2021, R-18268/14.05.2021 dhe R-17989/12.05.2021 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren. Pala e paditur e cila ka rivlerësuar mallin lëndor dhe ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve-DUD-ave kontestues, nuk ka provuar të vërtetoj se paditësi nuk ka deklaruar saktë vlerën e mallit lëndor, duke aplikuar në këtë rast transaksionet e mallrave identike apo të ngjashme dhe dosjen e vlerës nga neni 34 dhe 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Kolegji nga shkresat e lëndës nuk gjeti dëshmi se paditësi për vlerën e mallit lëndor, i ka paguar eksportuesit për DUD-at kontestues, vlerë më të lartë se sa vlera e deklaruar sipas dokumentacionit përcjellës. Meqë nga provat e administruara dhe nxjerrja e ekspertizës financiare datës 16.10.2023, me të cilën është dhënë vlersimi për secilën Deklaratë Unike Doganore, se nga faturat e prezantuara për DUD-at kontestues, të gjitha vlerat e faturave përputhen me vlerën e transfereve bankare ndërkombatare, Kolegji vlesoi se dhoma e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket pretendimeve ankimore për zbatim të gabuar të drejtës materiale, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nuk i aprovoi si të drejta, meqë dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të administruara dhe ekspertizës financiare, me të drejtë ka referuar rivlerësimin e mallit lëndor, në bazë të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 dhe Udhezimit Administrativ nr.11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, pasi që e paditura në arsyetimin e aktvendimit kontestues, në këtë drejtim nuk ka dhënë spjegime ligjore të mjaftueshme për të provuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e transaksionit e paguar për mallin me qëllim eksporti, në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjithashtu Kolegji nuk i konsideroi si të bazuara pretendimet ankimore se për DUD-in R-17989/12.05.2021 paditësi ka paraqit pagesa me status të përgatitur, jo të aprovuar, për arsye se në shkresat e lëndës gjendet Deklarata Unike Doganore R-17989/12.05.2021 ZBD Prizren, të cilës i janë bashkangjitur dokumentacioni përcjellës si: fatura e mallit nr.11553, EUR-1, deklarata eksportuese, dhe pagesa bankare e datës 15.07.2021 e paguar për faturën në fjalë, konfirmuar nga banka me status të aprovuar.

Prandaj, pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave ligjore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë pa bazuara dhe pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga dhoma e shkallës së parë. Sepse sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, Aktgjykimi i ankimuar i dhomës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Andaj, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1670/23 datë 18.01.2024

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,

Krenar Berisha